



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:049133

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05821373

C.nr.440/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar Shukrane Maloku, nga Prishtina, kundër të paditurit Xh.B., nga Peja, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit: 1.634€, në shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.12.09.2020, në prani të autorizuarës së palës paditëse, e në mungesë të të paditurit, me dt.13.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, ashtu që:

DETYROHET i padituri Xh.B., nga Peja, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e dt.01.07.2016, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1.634€, me kamat ligjore prej 8%, duke filluar nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja, nëpërmes të autorizuarit të saj, me padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke kërkuar që të detyrohet i padituri në rimbursimin e dëmit, të shkaktuar në aksidentin e dt.01.07.2016, me arsyetim se me provat e administruara është vërtetuar në tërësi se shkaktar i aksidentit ishte i padituri Xh., i cili në atë moment nuk kishte mbulesësiguruese-respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, andaj në bazë të Ligjit Mbi Sigurimin nga Auto përgjegjësia, ka potencuar se paditësja ka të drejtë të kërkoj ribursimin e dëmit nga shkaktari i pasiguruar, gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditëses t'a aprovoj në tërësi si të bazuar.

I padituri nuk ka dhenë përgjigje në padi, edhe pse për një gjë të tillë nga ana e gjykatës ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt që të veproi. I padituri po ashtu nuk ka prezantuar në seancat e shqyrtimit kryesorë, edhe përkundër faktit se ftesat i ka pranuar në mënyrë të rregullt, ashtu sikurse ftesën për seancën e fundit e cila i është lënë me lajmërim me dt.12.04.2024.

*Në propozim të autorizuarës së paditëses, gjykata konform dispozitës të nenit 423.4 të LPK-së, seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit rregullisht të ftuar.*

Gjykata në këtë çështje juridike-kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën ku si provë u administrua: Dosja e dëmit jo materiali me shenjën C.nr.../16, për aksidentin e dt.01.07.2016, ku janë të përfshira të gjitha provat e procedurës mbi kompensimin e dëmit, të dëmtuarit R.N., ku janë Ujdia Gjyqësore e dt.17.04.2018. dhe Urdhër transferi bankar i dt.03.05.2018, bashkë me të gjitha provat përcjellëse

për këtë çështje, ku është edhe ekspertiza e komunikacionit e Ing.Naser Nimanaj, për çështjen C.nr./16; Aktvendimi i Gjykatës Themelore Divizioni i Kundërvajtje në Pejë, K.nr.6-...16 të dt.12.07.2016-me të cilën është shpallur fajtor i padituri, si dhe deklarimet e të autorizuarës së palës paditëse.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike-civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se me datën 01.07.2016, rreth orës 12:00, në Pejë, në rrugën „...” në drejtim të Prishtinës-përballë marketit „...”, është shkaktuar aksident trafiku, në atë mënyrë që deri sa i padituri-ngasësi i motoçikletës „...”, pa targa nuk i’ka kishte përshtatur shpejtësin kushteve të rrugës dhe dendësisë së komunikacionit, dhe si rrjedhojë kur i dëmtuari R.N., nga P., ishte duke kaluar rrugën, paditësi nuk kishte arritur që ta ndaloj motoçikletën ashtu që kishte goditë këmbësorin-duke e rrëzuar në tokë, të cilit i janë shkaktuar dëme materiale dhe jo materiale...

Është vërtetuar edhe fakti se automjeti-motoçikletë, që ishte shkaktar i këtij aksidenti, në momentin e shkaktimit të tij, ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimeve.

Nga Pajtimi Gjyqësorë e dt.17.04.2018., gjykata ka konstatuar se i dëmtuari në këtë aksident R.N. nga P., të cilin e ka përfaqësuar sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve „Nikqi”, e cila me paditësen Byroja Kosovare e Sigurimeve, kanë lidhur pajtim gjyqësor për kompensimin e demit material dhe jo material, në shumën e tërësishëm prej 1.634€.

Nga dokument transferi në numër të llogarisë 1506 0010036303074, në Raiffeisen Bankë të dt.03.05.2018, gjykata ka konstatuar se paditësja, ka bërë pagesën e detyrimit sipas pajtimit gjyqësor, në llogari bankare të të autorizuarës së të dëmtuarit, si përfaqësuese e të dëmtuarit në këtë aksident.

Gjykata, gjenë se baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e demit paditëses, mbështetet në dispozitat e Rregullës 3, për Ndryshimin e Rregullit për Sigurimet e Detyruara të Auto Përgjegjësisë, nga Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës i dt.11.12.2007, e lidhur me dispozitat e nenit 245.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Paditësja është dashur t’ia kompensoj dëmin të dëmtuarit, për aksidentin e komunikacionit rrugor të dt.01.07.2016, në bazë të dispozitës së nenit 4.6.1 të Rregullit 3, mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë, në të cilën shprehimisht parashihet: *së në rast të demit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar Sigurimin e Detyruar të Auto përgjegjëses-zhdëmtimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte Sigurimi i Detyrueshëm e Auto përgjegjësisë nga Fondi i Garantues së Kosovës, në bazë të dispozitës së nenit 4.1, 2. pika a).*

Meqenëse paditësja, në bazë të provave prezent, në shkresat të lëndës ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarit, si pasojë e këtij aksidenti, ka të drejtë që të kërkoj rimbursimin e shumës të paguaj në bazë të nenit 4.6 pika 2 të Rregullit 3, e cila shprehimisht parasheh se pas pagimit të dëmshpërblimit mund të bëhet rimbursimin i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit, i cili nuk e ka siguruar automjetin, duke llogaritur këtu edhe kumatën me shpenzime.

*Sipas dispozitës së nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t’i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova*

me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t'i provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Meqenëse i padituri, me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, gjykata e vënë para një situatë të tillë, dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike të vërtetuar erdhi në përfundim se ekziston detyrimi juridik-civil, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumë prej 1.634€, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, *i cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij*, dhe si rezultat i kësaj paditësjë ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç'rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësjë e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Vendimi për kamatë gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ngase konsideron se nga momenti i nxjerrjes së aktgjykimit, pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, me arsyetim se nga ky moment e paditura kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar palës paditëse.

Lidhur me shpenzimet procedurale, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 463 të LPK-së, gjykata nuk vendosi, meqë asnjëra nga palët, nuk i ka kërkuar-specifikuar.

Mbi bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.440/20, me dt.13.06.2024.

G j y q t a r j a  
Afërdita Mulhaxha

**KËSHILLË JURIDIK:**

*Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtës, Gjykatës se Apelit, nëpërmjet kësaj gjykatë.*